



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 36 datë 26.10.2023

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR CAKTIMIN E DISA
KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË
VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË
SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkoder në mbledhjen e tij të datës 26.10.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr 8419, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Nenin 54, shkronja “k” të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiakë”; Ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar ; Ligjin nr. 8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; Ligjin nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” të ndryshuar; Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar; Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM nr.171 datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar”; VKM nr. 402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”; VKM nr.1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; VKM nr. 447, datë 16.6.2010 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”; VKM nr. 475, datë 30.7.2021 “Për bashkëpunimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”; Udhëzimin nr.5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”; Urdhër nr.935 datë 17.08.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative

dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e bashkisë Shkodër” dhe sipas relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin qëvendoset për to në territorin administrativ të bashkisë Shkodër”, sipas materialit bashkëlidhur, pjesë integrale e këtij vendimi
2. Kjo rregullore zbatohet me ndryshimin e paketës fiskale
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miraturar me 45 vota

Vota Pro 45

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 31.10.2023